



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 922/2 Prot.

Tiranë, më 10 /07/2018

**VENDIM**

Nr. 31, datë 10 / 7 /2018

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Ankuesja, Znj. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") ankesën nr. 922 Prot., datë 23.05.2018, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumentave zyrtare*" ndaj Autoritetit Publik "Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Me e-mail të datës 07.05.2018 ankuesja ka kërkuar nga Autoriteti Publik t'i vihen në dispozicion informacioni i disponueshëm lidhur me:

- 1- *Numrin e pacientëve përfitues për periudhën kohore 2015-2017 (nëse ka të dhëna, edhe për vitin 2018);*
- 2- *Numrin e pacientëve, të ndarë sipas spitaleve private, me të cilët FSDKSH ka nënshkruar kontratë për këto paketa, për periudhën kohore 2015-2017 (nëse ka të dhëna, edhe për vitin 2018);*
- 3- *Buxhetin e paguar nga FSDKSH, ndaj spitaleve private për përfituesit e këtyre paketave për periudhën kohore 2015-2017 (nëse ka të dhëna, edhe për vitin 2018)*
- 4- *Shuma e paguar nga vetë pacientët, në spitalet private si pasojë e mbulimit të pjesshëm nga këto paketa ( për shembull vendosja e më shumë se 1 STENT-i apo netë qëndrimi në spital);*
- 5- *Numri i pacientëve përfitues nga paketat e kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë, që kanë paguar shtesë për shërbimet e marra në spitalet jopublike. Ndarja e këtij numri sipas spitaleve jopublike që kanë nënshkruar kontratë me FSDKSH për këto paketa.*

Autoriteti Publik, me e-mailin e datës 18.05.2018 ka kthyer përgjigje duke dhënë një informacion të pjesshëm lidhur me objektin e kërkesës, si vijon:

*Sipas realizimit të financimit të paketave shëndetësore (kardiologjisë dhe kardiokurgjisë) për spitalet jopublike:*

- *Viti 2015: realizimi i buxhetit (kardiologjisë dhe kardiokurgjisë) 98 777, 907 lekë (angiografi 640, angioplastike 132, by pass aorto 66, Intervent valvolar 37);*
- *Viti 2016: realizimi i buxhetit (kardiologjisë dhe kardiokurgjisë) 97 335; 664 lekë (angiografi 478, angioplastike 113, by pass aorto 103, Intervent valvolar 31);*
- *Viti 2017: realizimi i buxhetit (kardiologjisë dhe kardiokurgjisë) 129 750; 178 lekë (angiografi 530, angioplastike 127, by pass aorto 127, Intervent valvolar 63, BI valvul me protezë metalike 1).*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesja ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes me shkresën nr. 922/1, datë 01.06.2018, i drejtoi Autoritetit Publik një kërkesë për parashtrime me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit sipas objektit të kërkesës.

Nga përgjigja e kthyer nga Autoriteti Publik rezulton se, nuk është dhënë informacion për të gjitha pikat sipas objektit të kërkesës, por një informacion i pjesshëm ku adresohet vetëm pika 3 e kërkesës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, Komisioneri vëren se informacioni i kërkuar është në trajtën e të dhënave statistikore. Si i tillë, mbi të nuk zbatohen kufizime të mundshme si ato të parashikuara në nenin 17, pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Bazuar në pikën 2, të nenit 2 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", informacion publik konsiderohet: "*...çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik*".

Gjithashtu, në pikën 3, të nenit 3 të tij, parashikohet se: "*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*".

E drejta e informimit, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Organet e administratës publike janë të detyruara t'i nënshtrohen parashikimeve kushtetuese dhe të konventës por dhe atyre të parashikuara në ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", me qëllim garantimin efektiv të parimit të transparencës. Kjo e

drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e llogaridhënies si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkcionimi i tyre do të ishte në interes të të dy palëve.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon:

**Neni 15** "1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhumueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre."

**Neni 23** "E drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore."

Në nenin 10 të KEDNJ është përcaktuar se: "Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë".

Sa më sipër, në lidhje me ankesën e Znj. \_\_\_\_\_ ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

### V E N D O S A:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës së Znj. \_\_\_\_\_, nr. 922 Prot., datë 23.05.2018, ndaj Autoritetit Publik "Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar sipas pikave 1,2, 4 dhe 5 të kërkesës për informim, brenda datës 18. 7.2018.
3. Rrëzimin e ankesës për informacionin e kërkuar në pikën 3 të kërkesës për informacion datë 07.05.2018.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
5. Ky vendim u dha shpall sot në datë 10. 7.2018.

**Besnik DERVISHI**

**KOMISIONERI**

